STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 9 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE BANKA KRYESORE NE SHTET PRANOJNE TE HEQIN PAGESAT E KONSUMATOREVE PAS SENDIT (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se disa banka kryesore të çertifikuara nga shteti kanë pranuar që të heqin një numër pagesash dhe pagesa ndëshkuese si reagim ndaj ndikimit mbi konsumatorët të Stuhisë Sendi (Sandy). Bankat e çertifikuara nga shteti që do të heqin pagesat përfshijnë M&T Bank, Apple Savings, Dime Savings Bank of Williamsburgh, Emigrant Savings Bank dhe New York Community Bank.

"Jeta e mijëra banorëve të Nju Jorkut është ndërprerë nga stuhia – përfshirë detyrimet dhe veprimtaritë e zakonshme financiare të tyre," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Si rezultat, disa njerëz mund të kenë pagesa të vonuara ose mund të detyrohen të pësojnë pagesa bankare dhe pagesa të tjera ndëshkuese. Për shembull, ata mund të mos jenë në gjendje t'u shmangen pagesave të ATM-ve nëse nuk mund të gjejnë një ATM që punon nga banka e tyre. Për të ndihmuar banorët e Nju Jorkut, bankat kryesore të çertifikuara nga shteti kanë pranuar të heqin pagesat dhe pagesat ndëshkuese, në mënyrë që konsumatorët të mos kenë këtë kosto shtesë. I bëj thirrje çdo banke të çertifikuar nga shteti ose nga federata që nuk ka hequr ende pagesat që të ndjekin këtë shembull."

Benxhëmin M. Loski (Benjamin M. Lawsky), Kryeinspektor i Shërbimeve Financiare, tha, "Shumë banka të çertifikuara nga shteti janë banka të komunitetit me lidhje të ngushta me zonat të cilave u shërbejnë, kështu që nuk është e habitshme se shumë janë të gatshme të ndihmojnë konsumatorët dhe bizneset në vend në këtë kohë të vështirë. Ky është një standart që shpresojmë se do t'a ndjekin të gjitha bankat tona."

Hollësitë mund të ndryshojnë nga banka në institucion dhe konsumatorët duhet të kontaktojnë bankën e tyre individuale për veçoritë. Në përgjithësi, bankat kanë pranuar që të heqin përkohësisht pagesat dhe pagesat ndëshkuese të mëposhtme të paktën deri më 15 nëntor dhe në disa raste edhe më tej:

- Pagesa të ATM-ve
- Tarifa për pagesa të vonuara
- Pagesa ndëshkuese për çeqet e kthyer për shkak të fondeve të pamjaftueshme
- Tarifa të transfertës të mbrojtjes nga tërheqja e më shumë parave sesa disponon

- Pagesa ndëshkuese për tërheqje të parakohëshme të kursimeve në rrethana kur konsumatori ka një nevojë të dukshme për fondet që rezulton nga katastrofa

Kryeinspektori Loski (Lawsky) gjithashtu u bëri thirrje bankave që të punojnë me depozituesit ose huamarrësit që janë prekur nga katastrofa. Bankat duhet të konsiderojnë rivlerësimin e nevojave të tanishme për kredi të komuniteteve për të ndihmuar në përmbushjen e atyre nevojave duke dhënë ose duke marë pjesë në hua të duhura. Ato gjithashtu duhet të konsiderojnë një ristrukturim të kujdesshëm të detyrimeve të borxhit të një huamarrësi të prekur, duke ndryshuar ose rregulluar kushtet e pagesës.

"Bankat vendore mund të luajnë një rol kryesor në ndihmën që komunitetet tona të rimëkëmben, ashtu siç kanë luajtur një rol kryesor në zhvillimin e tyre përpara stuhisë," tha Kryeinspektori Loski (Lawsky).

Institucioneve financiare që kërkojnë udhëzime shtesë për të ndihmuar konsumatorët e prekur nga ndikimi i Stuhisë Sendi (Sandy) u bëhet thirrje të kontaktojnë zyrën e Departamentit në Albani në 518-473-6160.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418